



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë- Ministarstvo Trgovine i Industrije- Ministry of Trade and Industry


Divizioni për Marrëveshje Tregtare / Departamenti i Tregtisë

Division for Trade Agreements / Department of Trade

**Tregtia në Shërbime në Kosovë– Përmbledhje e
shkurtër mbi tregtinë #2**

Autor: Mirsad Simnica

Gusht 2016



Hyrje

Kjo përmbledhje e shkurtër mbi tregtinë ilustron eksportin dhe importin e shërbimeve në Kosovë për periudhën prej tre vitesh. Bazuar në të dhënat të cilat i kemi mbledhur nga BQK-ja, ASK dhe baza e të dhënave të TSH dhe asociacionet e biznesit jemi munduar të gjenerojmë këtë përmbledhje të shkurtër për tregtinë në shërbime duke përfshirë edhe raundet e negociatave për liberalizimin e shërbimeve me anëtarët e CEFTA që ka filluar më shumë se 18 muaj më parë. Besohet se procesi i negociatave do të hap mundësi për tregje të reja, të cilat do t'i japin një stimul shtesë sektorit të biznesit dhe shërbimeve profesionale si tërësi, duke inkorporuar edhe komunikimin me shërbimet e tjera.

1.0 PASQYRA E TREGTISË SË SHËRBIMEVE NË KOSOVË

1.1 Balanci i tregtisë së shërbimeve në Kosovë për periudhën 2014 – 2016 (janar – qershor)

Tregtia në shërbime në Kosovë në vitin 2016 për një periudhë prej pesë muajve (janar - qershor) ka arritur në një total prej 397 milion eurove. Nga kjo shumë, totali i eksportit përfshinë një shumë prej 270 milion euro, ndërsa eksporti një shumë të përgjithshme prej 127 milion eurove. Kjo tregon një bilanc tregtar pozitivë prej 143 milion eurove. Nëse e krahasojmë me periudhën e njëjtë të vitit 2015, shohim se eksporti i shërbimeve në total ishte 256 milion euro, ndërsa në vitin 2014 ishte 236 milion euro në tregtimin ndërkombëtar të shërbimeve. Duke u bazuar në këto shifra, shohim se ka një trend pozitivë të rritjes së eksportit të shërbimeve me një mesatare prej 9.3%.

Sektorët kryesorë të cilët kontribuuan drejt një bilanci tregtar pozitiv janë: udhëtimet (turizmi) me eksport në vlerën prej 181 milionë euro, e ndjekur nga biznesi dhe shërbime profesionale me 23.7 milion euro, shërbimet e komunikimit me 19 milionë euro; shërbimet e ndërtimit me 5 milion euro; dhe shërbimet qeveritare me 14.5 milionë euro. Vlen të cekët se për herë të parë Shërbimet Afariste dhe Profesionale kanë një vlerë të lartë të eksportit kryesisht për shkak të hapjes së tregut me BE-në si dhe zgjerimin e furnizimit të shërbimeve nga Kosova në vendet e CEFTA dhe SHBA. Shërbimet e udhëtimit dhe turizmit kryesisht i atribuohen diasporës së Kosovës dhe shtetasve të huaj që punojnë në Kosovë.

Trendi negativ i tregtisë në shërbime (sa i përket importit të shërbimeve) duke se çdo vit e përfshinë një prej sektorëve kryesor: transportin me -35 milion euro në vitin 2016 (janar-

qershor). Të pasurit e një bilanci pozitiv të shërbimeve ka rezultuar në zvogëlimin e deficitit të lartë tregtar në mallra nga -860 milion euro në -717 milion euro.

Tabela 1: Bilanci i tregtisë në shërbime në periudhën 2014 – 2016 (Janar – Qershor).

Viti	Eksporti i shërbimeve (në milion)	Importi i shërbimeve (në milion)	Bilanci
2016	270	127	143
2015	256	150	106
2014	236	114	122

Tregtia në shërbimeve përbënë një pjesë të madhe të BPV-së, kryesisht falë prezencës së donatorëve në vend. Vlerësim i përgjithshëm i kontributit të shërbimeve në BPV ishte 73% në vitin 2015, sipas një vlerësimi nga Banka Botërore, që paraqet një rritje prej 9% nga viti 2004 kur kontributi në BPV ishte 64%.

Në tabelën e mëposhtme është ilustruar vlera e eksporteve dhe shërbimeve e shprehur në përqindje të BPV-së nga viti 2014-2016 (tremujori i parë)¹

Tabela 1.1: Përqindja e shërbimeve që kontribuojnë në Bruto Prodhimin Vendor

	2014	2015	2016
Eksporti i shërbimeve	11	11.9	12.3
Importi i shërbimeve	5.4	7	5.7

1.2 Shërbimet vjetore në vitin 2015

Në Kosovë shërbimet përbëjnë një përqindje të lartë të BPV-së, kryesisht falë prezencës ndërkombëtare në vend. Vlerësim i përgjithshëm nga Banka Botërore tregon se kontributi i shërbimeve në BPV-së është rreth 73%, që paraqet një rritje prej 9 pikë të përqindjes nga viti 2004 kur kontributi në BPV ishte 64%.

Shërbimet janë komponenti kyç i sektorit privat të Kosovës. Në mesin e sektorëve me performancën më të mirë konsiderohen të jenë: shërbimet e udhëtimit dhe turizmit, shërbimet e TIK dhe shërbimet afariste. Sektori bankar vlerësohet të jetë një prej sektorëve me

¹ Të dhënat e BPV janë përdorur vetëm për tremujorin e parë të secilit vitë (2014-2016), pasi që ende nuk i posedojmë të dhënat vjetore për vitin 2016, që të bëjmë krahasimet vjetore.

performancën më të mirë në kuadër të ekonomisë së Kosovës. Ai është përgjithësisht i qëndrueshëm, me ç'rast janë rritur depozitat dhe kredit për sektorin privat pavarësisht krizës financiare globale.

Tregtia në shërbime u karakterizua nga një rritje pozitive e bilancit në vitin 2015. Bilanci i shërbimeve arriti në 355 milion euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 5.5 përqind, që vjen si rezultat i rritjes më të shpejt të eksportit të shërbimeve në krahasim me importin e tyre.

Eksporti i shërbimeve është rritur me 4 përqind në vit, duke arritur kështu vlerën prej 797 milion eurove. Në të njëjtën periudhë vlera e importit të shërbimeve u rrit për 2.5 përqind duke arritur në 442 milion euro. Në kuadër të shërbimeve të eksportit, shërbimet e udhëtimit u karakterizuan nga një rritje vjetore prej 12.0 përqind në vitin 2015 me një total të eksportit prej 565 milion eurove; kategoria e TIK arriti në 55 milion euro, ndërsa shërbimet e tjera afariste në 61 milion euro. Sa i përket shërbimeve të importit, dy kategori shumë të rëndësishme të shërbimeve kanë pasur një performancë negative: transporti është rritur për 47.3% në krahasim me vitin 2014, përkatësisht nga 99.6 milion euro në 147 milion euro, ndërsa importi i shërbimeve të sigurimit dhe pensioneve është rritur për 9.2% nga 35 milion euro në vitin 2014 në 38 milion në vitin 2015.

Tabela 1.2: Bilanci i tregtisë në shërbime për periudhën 2013 – 2015.

Viti	Eksporti i shërbimeve (në miliona)	Importi i shërbimeve (në miliona)	Bilanci
2015	797	442	355
2014	767	431	336
2013	632	320	312

Tabela 1.2 tregon se ka pasur një rritje të konsiderueshme të eksporteve nga vitit 2013 deri në 2015 me 79%, si rezultat i performancës së kategorisë së udhëtimeve dhe turizmit, TIK dhe shërbimeve të tjera afariste.

Tabela 1.3: Përqindja e shërbimeve që kontribuojnë për Bruto Prodhimin Vendor (BPV)

	2013	2014	2015
Eksporti i shërbimeve	11.7	13.7	13.9
Importi i shërbimeve	5.9	7.7	7.7

2. Tregtia në Shërbime, OBT DHE MPTSH

Organizata Botërore e Tregtisë (OBT) me Marrëveshjen e Përgjithshme për Tregtinë me Shërbime (ang:GATS) ka zhvilluar një nomenklaturë specifike për llogaritjen e eksportit të shërbimeve. Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve korrespondon me transaksionin mes një prodhuesi dhe konsumatori që gjenden ligjërisht në vende apo territor doganore të ndryshme, duke përdorur mënyra të ndryshme të furnizimit (shih tabelën e mëposhtme për detaje) si për eksportin ashtu edhe për importin e shërbimeve.

TREGTIA NË SHËRBIME – KATËR METODAT E FURNIZIMIT	
Metoda 1 – Furnizimi ndër-kufitar: transaksioni përtej kufirit pa lëvizjen e prodhuesit apo konsumatorit. Kjo metodë kryesisht bëhet përmes e-tregtisë apo përmes internetit. Shembujt: konsulenca apo raportet e hulumtimit të tregut, këshilla tele-mjekësore, trajnimi në distancë, etj.	Metoda 2 – Konsumi jashtë vendit: një konsumator nga vendi A shkon në vendin B dhe paguan për shërbimet të cilat i merr. Shembujt: pushimet në Shqipëri apo në Turqi, arsimimi në universitetet jashtë vendit, etj.
Metoda 3 – Prania komerciale: Një furnizues i shërbimeve themelon degën, zyrën apo filialin e saj në vendin ku gjendet konsumatori. Shembujt: degët apo filialet e bankave të huaja, kompanitë e telekomunikimit, etj.	Metoda 4 – Prania e personave fizik: Profesionistët e huaj që ofrojnë shërbime për konsumatorët në vendin pritës Shembujt: mjekët, kontabilistët, avokatët, që punojnë në vendet e huaja, etj.

Burimi: ueb-faqja e OBT (www.wo.org)

MPTSH – është një marrëveshje shumëpalëshe tregtare në kuadër të OBT, e cila është negociuar gjatë Raundit të negociatave në Uruguai dhe që ka hyr në fuqi në vitin 1995. Objektivi i kësaj marrëveshje tregtare shumëpalëshe për shërbimet ishte të krijoj një sistem të qëndrueshëm të rregullave tregtare ndërkombëtare, të siguroj transparencën e regjimeve tregtare, dhe një trajtim të drejt dhe të barabartë të pjesëmarrësve, të promovoj tregtinë dhe si rezultat të stimuloj rritjen ekonomike si dhe zhvillimin përmes një liberalizimi progresiv tregtar. Kosova në kuadër të aspiratave të saj që në të ardhmen të bëhet anëtare e OBT-së duhet të ju përmbahet dispozitave të MPTSH, që është korniza globale për rregullimin e tregtisë në shërbime.

3.1 Negociatat e CEFTA

Negociatat për tregtinë në shërbime janë organizuar në gjashtë raunde të negociatave dhe ishin paraparë të përfundojnë brenda 18 muajve nga sesioni i parë i negociatave. Data e fundit për përfundimin e negociatave pritet të jetë nëntori i vitit 2016.

Dymbëdhjetë sektorët i janë nënshtruar liberalizimit me orarin e mposhtëm tentativ::

- Raundi i 1 dhe 2 – shërbimet afariste dhe profesionale
- 3 – turizmi, mjedisi, shërbimet rekreacionale (minus ato audiovizuale)
- 4 – shërbimet e komunikimit dhe shërbimit
- 5 – shërbimet e distribimit, arsimit dhe shëndetësisë
- 6 – shërbimet financiare, transportit dhe audiovizuale
- 7 dhe 8 – rishikimi i sektorëve të zotuar për ndryshime dhe negociata shtesë

Raundi i parë i negociatave (shërbimet e biznesit dhe ato profesionale) është mbajtur më 6 nëntor të vitit 2014 në Shkup të Maqedonisë. Në takim morën pjesë përfaqësues nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova.

Raundi i dytë i bisedimeve i kryesuar nga Moldavia u mbajt më 26 shkurt të vitit 2015 në Bruksel dhe aty u negociuan shërbimet afariste dhe profesionale ashtu siç ishte planifikuar për dy raundet e para. Raundi i tretë i negociatave është mbajtur më 29 - 30 qershor të vitit 2015 në Moldavi.

Raundi i katërt i negociatave u mbajt më 17-18 shtator ndërsa raundi i pesë i negociatave, po ashtu në Moldavi u mbajt më 23 nëntor të vitit 2015, ndërsa raundet e fundit të negociatave që përfshijnë (financat, transportin dhe shërbimet audiovizuale) si dhe rishikimin e sektorëve të përkushtuar për ndryshimet shtesë do të mbahen në Mal të Zi gjatë vitit 2016.



3.2 PËRFITIMET DHE SFIDAT E LIBERALIZIMIT TË TREGTISË NË SHËRBIME


Për sa i përket punësimit dhe prodhimtarisë, shërbimet po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme për rritjen ekonomike. Kosova mund të përfitojë nga liberalizimi i shërbimeve nëse ajo e rrit konkurrencën nga ana e ofertës (zgjedhje shtesë e ofruesve të shërbimeve). Aktualisht, Kosova ka një regjim mjaft liberal të tregtisë së shërbimeve. Megjithatë, mbizotërojnë pengesat për ofruesit e shërbimeve të Kosovës për të hyrë në tregjet tjera, veçanërisht ato rajonale dhe tregjet më të gjera evropiane. Përmes marrëveshjeve bilaterale dhe rajonale, kompanitë dhe individët e Kosovës do të përfitojnë nga qasja në tregje të ndryshme të reja në kuadër të CEFTA-s dhe vendeve të BE-së, edhe pse, kjo kushtëzohet nga niveli i konkurrueshmërisë dhe cilësia e shërbimeve të ofruara nga ofruesit e shërbimeve nga Kosova.

Heqja e kufizimeve me Njohjen Reciproke të Kualifikimeve (NRK) për qasje në treg nga vendet e tjera, veçanërisht vendet e CEFTA-s, do t'u mundësojë inxhinierëve, avokatëve, kontabilistëve, mjekëve, arkitektëve dhe shumë profesionistëve tjerë të Kosovës të ofrojnë shërbimet e tyre në rajon dhe të zhvillojnë aftësi të reja. Krijimi i një tregu më të madh shpesh do të përmirësojë cilësinë e shërbimeve, do të ul çmimet dhe në këtë mënyrë do të rrit konkurrencën. Sa i përket punësimit, ai do të krijojë më shumë vende pune, duke përvetësuar aftësi dhe teknologji më të mira dhe të reja.

Përparësitë e liberalizimit të tregut të shërbimeve janë:

- Krijimi i qasjeve të reja në treg për kompanitë dhe individët;
- Tregjet e huaja mund të penetrohen më lehtë dhe me kosto më të ulëta;
- Ulja e çmimeve për shërbimet e ndryshme në treg si rezultat i efektit të konkurrencës;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët e Kosovës dhe qytetarët e vendeve negociuese.

Mirëpo, procesi i liberalizimit të shërbimeve është shpesh sfidues, sepse Kosova do të mund të përballlet me shumë pengesa gjatë procesit të negociatave. Njëra nga sfidat kryesore është plani i zotimeve ku një vend duhet të jetë shumë i kujdesshëm për çka të zotohet dhe si do të ndikojë ajo në sektorë të veçantë dhe në cilin nivel.



4.0 Projektligji për shërbimet

Në vitin 2015 është përgatitur Projektligji për Shërbimet, në përputhje të plotë me Direktivën e BE 2006/123/EC për Shërbimet në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, me mbështetjen e Projektit të BE-së për Politikën Tregtare, një ligj i cili do të miratohet gjatë vitit 2016 pas miratimit të Planit Kombëtar për miratimin e Acquis të BE-së. Megjithatë, në përputhje me procedurat e hartimit të akteve ligjore, një koncept dokument mbi ligjin për shërbimet është hartuar nga ana Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe është miratuar nga Zyra e Kryeministrit. Sipas procedurave për hartimin e legjislacionit, do të fillojmë me miratimin e projektligjit në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe më pastaj e dërgojmë në Qeveri për aprovim dhe në Kuvend për miratim. Për më tepër, ashtu siç tregohet më lart, këtë vit Qeveria e Kosovës e ka hartuar dhe miratuar një Plan Kombëtar për Miratimin e Acquis, ku është paraparë harmonizimi i plotë i legjislacionit të Kosovës me acquis e BE-së. Në fushën e shërbimeve, Direktiva e BE-së 2006/123/EC për Shërbimet është planifikuar të miratohet plotësisht brenda gjashtë vjetëve nga hyrja në fuqi e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit e nënshkruar mes Kosovës dhe BE-së, siç kërkohet nga institucionet e BE-së.

KONKLUZIONI

Tregtia në Shërbime ka pasur një ndikim të rëndësishëm në ekonominë e Kosovës, fillimisht duke mbyllur boshllëkun e madh të lënë nga niveli i ulët i eksporteve të mallrave. Sektorët e shërbimeve e në veçanti udhëtimi/turizmi; sektori i shërbimeve të tjera afariste dhe komunikimit kanë performuar jashtëzakonisht mirë. Bazuar në dëshmitë e paraqitura, shërbimet kanë kontribuar në zvogëlimin e problemeve strukturore në ekonominë e Kosovës, e sidomos të papunësisë. Megjithatë, trendët tregojnë që potenciali i rritjes së shërbimeve është edhe më i lartë. Ndërgjegjësimi i qeverisë në lidhje me këtë potencial të madh të shërbimeve me qëllim të investimit dhe promovimit më të madh në fusha dhe sektor të caktuar, mund të nxis eksport më të madh të shërbimeve, të tërheq investitor të huaj të mëdhenj si dhe të ulë shkallën e papunësisë.